

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE



NR. 2447 REP.

NR. 1393 KOL. 1/2

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot ne daten 20/06 / 2019 para meje noter Alket Z. Mançka prane Dhomes se Noterise Tirane, Zyra Noteriale Tirane, Lagjia Nr. 2 ; Rruga " Asim Zeneli " Pll. Nr 10 ,u paraqiten personalisht palet si me poshte :

SHITESI

1. Shoqeria Pharma Venture SA, ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise "FARMAWORLD" shpk, rregjistruar ne QKB ne date 22/12/1993, me Nr.NIPT J61814025E me seli ne adresen Rr.Fadil Rada, Mbrapa Ish ATSH, pronar i 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.(ketu me poshte te quajtur **Shites**), perfaqesuar nga Av.Arben Llapi, anetar i Dhomes se Avokatise Tirane, me Nr.Lic.2277, i identifikuar me ID Nr. 024858071, sipas Prokures se Posacme e dates 08.04.2019.

BLERESI

1. Z.Illir Vuthi,i biri i Hilmi dhe Drita , i datelindjes 16.10.1960, lindur dhe banues ne Tirane,me adrese Rr. Dervish Hima Pall. 4, Sh.5,Ap 25 mbajtes i pasaportes Nr. BR7198654.
2. Shoqeria "GUERRIERO" Srl, me adrese ne Itali Margherita Di Savoia, (FG) Via V.Veneto, 85-87 Via Gorizia 6, me nipt 03474900713, e perfaqesuar nga Z. Alberico Guerriero, mbajtes i Pass Nr. YA8951728.
(ketu me poshte te quajtur **Bleresit**).

MEQENESE

Shitesi zoteron 100% (njqind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. , ne vlere nominale 100,000 leke fakt qe konfirmohet nga Ekstrakti i Thjeshte i shoqerise printuar nga sistemi . Shoqeria Shitese , me Vendimin vertetuar nga Noteri ne daten 07.05.2019 ka vendosur shitjen e 100% te kuotave te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. respektivisht :

1. 46.2% (dyzetegjashte pike dy) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. ne vlere nominale prej 46 200 leke tek bleresi Ilir Vuthi dhe
2. 53.8 % (pesedhete e tre pike tete) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. ne vlere nominale prej 53 800 leke tek bleresi shoqeria " Guerriero " s.r.l.

Sa me sipër palet bien dakort si me poshte vijon:



Neni 1 OBJEKTI I KONTRATES

Ne perputhje me kushtet dhe dispozitat e kesaj kontrate shitesi i shet bleresit Ilir Vuthi 46.2 % te kuotave respektive te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. ne vlere nominale prej 46 200 leke dhe shoqerise " Guerriero " s.r.l. 53.8 % te kuotave te Shoqerise te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. ne vlere nominale prej 53 800 leke te cilat ne total perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise " FARMAWORLD " sh.p.k. , te lira prej cfaredo pengu apo barre.

Traferimi i pronesise mbi kuotat do te kryhet me nenshkrimin e kesaj Kontrate nga Palet.

Bleresi Ilir Vuthi do te behet pronar i 46.2 % (dyzet e gjashte pike 2 perqind)te kuotave te shoqerise Farmaworld sh.p.k. dhe do te siguroje cdo disident te deklaruar dhe te paguaj te gjitha detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga titulli i pronesise mbi kuotat.

Bleresi shoqeria Guerriero srl do te behet pronar i 53.8 % (pesedhete e tre pike tete perqind)te kuotave te shoqerise Farmaworld sh.p.k. dhe do te siguroje cdo disident te deklaruar dhe te paguaj te gjitha detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga titulli i pronesise mbi kuotat.

Neni 2 CMIMI I BLERJES

2.1 Vlera totale e shitjes se 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 100 000 leke nga pala shitese te palet blerese eshte likujduar nga bleresit jashte kesaj zyre dhe shitesi deklarone se ka marre ne dorezim vleren e plote te saj.

2.1 Shitesi pranon qe regjistrimi i kesaj kontrate prane Regjistrimit Tregtare prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te kryhet menjehere pas nenshkrimit te kesaj kontrate nga te dy palet.

Neni 3 DEKLARIME DHE GARANCI TE SHITESIT

3.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaje Kontrate, Shitesi deklarone dhe garantone se:

- 1) Eshte zoterues i vetem i ligjshem i numrit te kuotave te percaktuara ne nenet e mesiperme te kesaj Kontrate.
- 2) Kuotat jane te lira prej cfaredo pengu apo barre te cfare d olloji dhe Shitesi gezon te drejten, kompetencen dhe autoritetin e plote te shese, kaloje, transferoje dhe dergoje kuotat ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.
- 3) Shitesi ka te gjitha kompetencat per te nenshkruar dhe ekzekutuar kete Kontrate.
- 4) Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe operon e pajisur me licensen e rregullt te leshuar nga autoritetet kompetente.
- 5) Nuk kekohet asnje miratim nga autoritetet licensuese per te shitur, kaluar, transferuar ose derguar kuotat tek Bleresi.

Shitesi deklarone me pergjegjesi te plote se Shoqeria "FARMAWORLD " shpk eshte e lire nga cdo barre apo detyrim ndaj paleve te treta, shtetit institucionve private financiare apo dhe subjekteve te tjera private apo kushdo qofshin keto. Kuotat e shoqerise jane te lira dhe nuk kane asnje bllokim, pengese apo sekuestro konservative. Gjithashtu shitesi deklarone se te gjitha asetet e shoqerise jane te lira dhe pa barre apo bllokim ndaj tyre dhe shoqeria nuk ka asnje ekspozim bankar ne asnje banke te nivelit te dyte te Republikes se Shqiperise.



Neni 4

DEKLARIME DHE GARANCI TE BLERESIT

- 4.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, Bleresit deklarojne dhe garantojne se nuk kane asnje pengese ligjore per lidhjen e kesaj Kontrate.
- 4.2 Bleresit deklarojne se jane ne dijeni te plote te situates ligjore dhe financiare te Shoqerise, te aseteteve ne pronesi te Shoqerise dhe e pranojne shoqerine sic eshte ne daten e transferimit te pronesise, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet.

Neni 5

SHPENZIMET DHE TAKSAT

- 5.1 Pavec se kur parashikohet ndryshe nga kjo Kontrate, secila nga Palet do te paguaje vete shpenzimet ne lidhje me negociimin dhe pergatitjen e kesaj Kontrate.
- 5.2 Te gjitha kostot per sherbimet e noterizimit dhe kosto te tjera te perballuara ne lidhje me nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te perballohen nga Bleresit.

Neni 6

LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

- 6.1 Kjo Kontrate si dhe te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin per Palet nga kjo Kontrate do te rregullohen, interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar aktualisht ne fuqi.
- 6.2 Ne rast se lindin mosmarreveshje midis Paleve ne lidhje me interpretimin, lidhjen, zbatimin, shkeljen, zgjidhjen dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate, Palet do te kryejne cdo veprim me mirebesim per zgjidhjen me mirekuptim te mosmarreveshjes.
- 6.3 Te gjitha mosmarreveshjet te cilat do te lindin midis Paleve ne lidhje me zbatimin e kesaj Kontrate, dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 7

FORCA MADHORE

- 7.1 Asnjera nga Palet nuk do te konsiderohet pergjegjese nese permbushja e dispozitave te kesaj Kontrate do te jete ne vonese ose e pamundur per shkak te forces madhore, dhe vecanterisht i rezultat i revolucioneve, kryengritjeve, protestave popullore, luftes, grevave, zjarrit, permbytjeve apo fenomeneve te mbinatyreshme te cilat kufizojne lirine personale dhe ate te sipermarjes se Paleve.

Neni 8

DISPOZITA TE NDRYSHME

- 8.1 Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote midis Paleve ne lidhje me ceshtjen objekt te kesaj Kontrate, dhe mbizoteron mbi te gjitha marreveshjet e meparshme me shkrim ose me goje, si dhe mbi te gjitha komunikimet ndermjet Paleve ne lidhje me ceshtjen objekt te kesaj Kontrate.
- 8.2 Pavecse kur eshte parashikuar ndryshe ne kete Kontrate, cdo ndryshim i saj mund te kryhet vetem me shkrim dhe te nenshkruhet nga te dyja Palet.
- 8.3 Palet bien dakort qe kushtet e kesaj Kontrate te mbeten konfidenciale dhe nuk mund te behen publike tek te tretet, pavec se kur berja publike lidhet me permbushjen e detyrimeve ligjore.
- 8.4 Kjo Kontrate perpilohet ne 5 kopje me vlere te barabarte.

SHITESI

PHARMA VENTURE SA

Perfaqesuar me prokure te posacme nga
Av. Arben LLAPI



BLERESIT

ILIR VUTHI

Ilir Vuthi
ff

**GUERRIERO SRL
ALBERICO GUERRIERO**

Alberico Guerriero

**NOTERI
ALKET Z MANÇKA**

[Large handwritten signature]



Guerriero s.r.l.

Via Gorizia, 6
Corte Margherita di Savoia (BT)
☎ 0883 657465 - Fax 0883 657469
Vat IT 03474900718